

VENDIM
Nr.119, datë 9.10.2008

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “UNIVERSI” SHPK NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9, 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 5, 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.121, datë 4.4.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.10.2008, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Universi” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike

dhe konstatoi se:

- Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të “Universi” sh.p.k., ka nisur me marrjen e vendimit nr.85, datë 17.7.2008.

- Rregullorja për procedurat e licencimit e miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008 në nenin 20 parashikon se për të gjitha aplikimet e paraqitura para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje do të aplikohen rregullat e përcaktuara në rregulloren e procedurave të licencimit të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007.

- Aplikimi i shoqërisë për t’u licencuar në aktivitetin e tregtimit është në përputhje me kërkesat e vendosura nga ERE, në përputhje me rregulloren për procedurat e licencimit, për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Universi” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta